Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 02-02-2015
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|
| 01- | 013/ | 115 | |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Bazuar në nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 30.01.2015 aprovon këtë:

# V E N D I M

## PËR SHPALLJEN E DISKUTIMT PUBLIK PËR PROPOZIM RREGULLOREN PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENT TË KOMUNËS SË VITISË

I.

Kuvendi i Komunës së Vitisë SHPALL diskutim publik për propozim Rregulloren për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë.

II.

Propozim Rregullorja për ndarjen e bursave për Student të Komunës së Vitisë do të jepet në diskutim publik deri më 16 shkurt 2015.

III.

Debati me publikun do të mbahet më 16 shkurt 2015 në ora 10,$^{00}$ në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë,

IV.

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

V.

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozimet e bëra për Propozim Rregulloren për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë , para se të miratohet në Kuvend.

VI.

Materiali lidhur me propozim Rregulloren për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë mund të merret në Shërbimin e Kuvendit, Zyrën Ligjore dhe i njëjti do të jetë i shpallur në tabelën e shpalljeve dhe në Veb faqen e Komunës së Vitisë në internet.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira